



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 05.03.2025
Numër Protokollit: 2034/2025

A.nr.188/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.188/2025, të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesi S.SH të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Naim Cahanaj nga Prizreni, kundër organit të punësimit "Agjencisë së Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës", në çështjen juridike "transferim", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.188/2025, e datës 23.01.2025, e parashtruar nga ankuesi S.SH.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.56/2024, i datës 23.12.2024, i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, S.SH (*tutje referuar vetëm* ankuesi), më datë 20.01.2025 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar më datë 23.01.2025, kundër Vendimit me Nr.56/2024, të datës 23.12.2024, të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, për shkak të transferimit me rastin e ristrukturimit të institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.01.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në

Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (tutje referuar AKKVP), ndërsa kjo e furnit më datë 07.02.2025, ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 489/2025 të datës 23.01.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.56/2024, të datës 23.12.2024, të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës; Akt Emërimit e ankuesit të datës 06.01.2025; Diplomën me Nr. D-834/20 të datës 24.08.2020; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.06.2009; Formularin e vlerësimit të rezultateve ne punës i datës 25.01.2022, 21.01.2023 dhe 26.01.2024; Certifikatën trajnimi e datës 13.12.2012, e datës 29.05.2016, e datës 29-31.08.2016, e datës 11.05.2023, e datës 01.06.2018; Autorizimin e datës 20.01.2025; Plikon e datës 20.01.2025; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 31.01.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 07.02.2025; Akt Emërimit e datës 01.01.2012; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt të Emërimit të datës 30.07.2015, datës 08.08.2018, datës 28.12.2020; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën “Asistent i Shërbimit të Procesimit; Vendimin e datës 25.04.2024 me shifër Ref.nr:00561/24; Raporti me Rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit i datës 02.12.2024; Shkresë e datës 20.11.2024 të Komisionit të Ristrukturimit; Raportin e vlerësimit të kandidatëve për pozitën Zyrtar i lartë për Koordinimin Regjional i datës 20.11.2024; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “Notifikues”.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit e përcaktuar si në dispozitivin e këtij vendimi është e ***paabazuar***, sepse:

Nga administrimit i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 28.12.2020, ankuesi është i punësuar në pozitën Asistent i Shërbimit të Procesimit, në kuadër të Zyrës Regjionale në Prizren të AKKVP-së.

Tutje nga provat materiale, rrjedhë se AKKVP, ka miratuar Rregulloren Nr.01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës ne Agjencinë e Kosovës për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, U.d Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në AKKVP, me Vendimin me Ref.nr: 00561/24, të datës 25.04.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit AKKVP, ndërsa ky i fundit më datë 02.12.2024 ka miratuar Raportin Përfundimtar Ref.Nr.01809/20244, ku lidhur me procesin e ristrukturimit te ankuesit ka rekomanduar citojmë: *...pasi që pozita me titull Asistent i Shërbimit të Procesimit është shuar në strukturën e re organizative e, komisioni propozon që zyrtar në fjalë, të sistemohet brenda të njëjtës klasë profesionale 3 në Zyrën regjionale në Prizren në pozitën Notifikues., Zyrtar ka marr pjesë në garën për pozitën Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional, klasa profesionale 1, por nuk ka arritur të grumbulloj numrin e nevojshëm të pikëve për t’u emëruar në këtë pozitë, zv. Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore të AKKVP-së, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit të Ristrukturimit me Vendimin Nr.56/2024, të datës 23.12.2024, ka transferuar ankuesin në pozitën e punës Notifikues.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.56/2024, të datës 23.12.2024, të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore të AKKVP-së, pretendon se Komisioni i Ristrukturimit ka shkelur nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, pasi nuk ka marr për bazë kualifikimet për caktim në opozitë, nuk ka marr për bazë mesataren e vlerësimeve për tri vitet e fundit, dhe po ashtu nuk ka marr për bazë trajnimet. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar me ankesë dhe të obliguar AKKVP të merr vendim që të transferoj në pozitën Zyrtar i Notifikimin në profesionale 2.

Në kuptim të vendosjes meritorie lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës së transferimit të nëpunësve civil në rast të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, respektivisht mori për bazë nenin 66 i cili përcakton se: *“1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion; 2.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësja/i; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësve/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës. 4. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia përgjegjëse në bazë të propozimit të komisionit. 5. Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsye të parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil. 6. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3. të këtij neni, drejtohet nga njësia përgjegjëse dhe në të bëjnë pjesë përfaqësueset e institucioneve të parashikuara në nën-paragrafët 2.1., 2.2., 2.3. apo 2.4. të këtij neni, sipas rastit ku bëhet ristrukturimi përkatës. 7. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton procedura të hollësishme për zbatimin e këtij neni. 8. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve”.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit, ju referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë konkretisht nenit 12, i cili përcakton se: *1. Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori. 2. Shuarja apo ristrukturimit i institucionit përcaktohet në legjislacionin përkatës për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. 3. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet: 3.1. në të njëjtin institucion; 3.2. në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 3.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 3.4. në një institucion tjetër të shërbimit civil. 4. Transferimi bëhet sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni. Nëse nuk ka pozita të lira të së njëjtës kategori apo*

nëpunësi nuk plotëson kërkesat e pozitës së punës në të njëjtin institucion sipas nënparagrafit 3.1. të këtij neni, transferimi i tij mund të bëhet në institucionin tjetër sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 3. 5. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar njoftohen individualisht nga NjMBNj për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit. Njoftimi bëhet menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit të institucionit dhe nenit 13 paragrafi 1 i cili përcakton: 1. Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, DMZP për institucionet e administratës shtetërore, apo NjMBNj për institucionet e tjera, brenda 30 ditëve nga miratimi i aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, për të cilën ky i fundit i plotëson kërkesat e vendit të punës.

Rrjedhimisht, referuar kuadrit ligjor si më lartë dhe në vështrim të së drejtës së nëpunësit në procesin e ristrukturimit, Kolegji ka analizuar Rregulloren Nr. 01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AKKVP dhe si rrjedhojë ka konstatuar së pozita e ankuesit Asistent i Shërbimit të Procesimit nuk është paraparë në strukturën e re organizative, atëherë edhe ankuesi si rezultat i shuarjes së pozitës duhet ti nënshtrohet procedurës së ristrukturimit duke respektuar në përpikëri kërkesat ligjore sipas nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nga analizimi i provave të lëndës Kolegji i Këshillit gjeti se Komisioni i Ristrukturimit për pozitën e re të krijuar “Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional”, ka përfshirë në pikëzim tre (3) kandidatë me qëllim të propozimit për transferim të tyre në këtë pozitë, gjegjësisht duke vepruar sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë respektivisht nenit 13 paragrafi 7, dhe paragrafi 8 ku përcaktohet: “7. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 7.1. përvojën e nëpunësit në shërbimin civil; 7.2. mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit; 7.3. kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe 7.4. trajnimet e nëpunësit; 8. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kritereve të përcaktuara në paragrafin 7 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter” , rrjedhimisht, lidhur me pozitën e re të krijuar “Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional” është aplikuar edhe metodologjia e njëjtë e vlerësimit të kritereve apo e pikëzimit për të tre zyrtarët nga Komisioni i Ristrukturimit sikurse përcaktohet në paragrafin 8 të nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, mirëpo dy zyrtar tjetër kanë arritur pikë më shumë se ankuesi, gjegjësisht njëri ka grumbulluar 60 pikë, tjetri 58 pikë, kurse ankuesi vetëm 52 pikë. Në rastin e vlerësimit sipas tabelës së pikëzimit të dy kandidatët tjerë në raport me ankuesin kanë pasur përvojë punë më të gjatë në shërbimin civil, respektivisht njëri ka pasur përvojë pune prej 18 vitesh, ndërsa tjetri përvojë pune prej 21 vitesh, kurse ankuesi ka përvojë punë prej 15 vitesh, sa i përket mesatares së vlerësimeve të rezultateve në punës të tre kandidatet janë vlerësuar me nga 20 pikë, sa i përket kritereve profesionale kandidati i parë meqë ka pasur nivel të studimeve bachelor dhe master është vlerësuar me 15 pikë, ndërsa kandidati tjetër dhe ankuesi meqë kanë pasur vetëm bachelor janë vlerësuar me nga 10 pikë, sa i përket trajnimeve si trajnime relevante për pozitë që janë vlerësuar asnjë nga kandidatët nuk kanë pasur trajnime relevante, ndërsa për trajnime të tjera të gjithë kandidatët janë vlerësuar me nga 7 pikë, si rezultat i këtij vlerësimi, ankuesi nuk ka mundur të transferohet në pozitën Zyrtar i Lartë për Koordinim Regjional, sepse transferimi është bërë mbi bazë të numrit më të madh të pikëve.

Kolegji i Këshillit analizoi, përshkrimin e detyrave të punës për pozitën në të cilën ankuesi është transferuar “*Notifikues*”, dhe konstatoi se pozita në fjalë është grupuar në kuadër të Grupit të Administrimit të Përgjithshëm, ndërsa për pozitën në fjalë kriter është kualifikimi arsimit të lartë e nivelit të parë (**bachelor**), ndërsa fusha e arsimimit është e paspecifikuar, ndërsa nga dosja e ankuesit rezulton se i njëjti posedon Diplomën me Nr. D-834/20 të datës 24.08.2020 të lëshuar nga Kolegji ISPE, përmes së cilës dëshmohet se më datë 28.07.2020 i njëjti ka kryer studimet themelore në Programi Ekonomik dhe ka marr titullin Baçelor i Arteve në Ekonomik me Specializim në Banka, Financa dhe Kontabilitet, nga rrjedh se Komisioni i Ristrukturimit me rastin e rekomandimit të transferimit si dhe Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e transferimit të ankuesit ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, neni 63 paragrafi 3 ku përcaktohet se: “*Në çdo rast shuarje apo rristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i rristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunëse/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunëses/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës.*”, ngase për pozitën përkatëse ku ankuesi është transferuar nuk kërkohet fushë specifike e arsimimit, por mjafton të ketë të mbaruara studimet themelore të arsimit të lartë dhe të ketë fituar titullin Baçelor, ndërsa ankuesi dëshmohet se ka këtë titull të arsimimit.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se, Komisioni i Ristrukturimit i AKKVP-së në bazë të mandatit të tij ligjor, ka mandat që në rast të shuarjes apo rristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunëse/i civil shuhet, ajo/ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, mbi këtë rrjedhë konstatimi se ankuesi edhe para rristrukturimit ka mbajtur pozitë të kategorisë profesionale të klasës Profesional 3, ndërsa pas rristrukturimit pozita e krijuar si pozitë e re “*Notifikues*” hyn në kuadër të kategorisë së pozitave profesionale dhe është paraparë në klasën Profesional 3, në këtë rast me rastin e propozimit të transferimit të ankuesit në këtë pozitë, ka vepruar në pajtim me nenin 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 12, 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse ankuesi është propozuar të transferohet në kategori të njëjtë gjegjësisht në klasë të njëjtë që ka pasur para transferimit, e për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi me rastin e transferimit nuk është dëmtuar në kategori apo klasë dhe do të marr koeficientin e pagës së njëjtë, andaj nisur nga theksimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se nëpunësi civil mund të refuzoj transferimin vetëm në rastet e parashikuara me nenin 66 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është paraparë se: “*Nëpunësja/i mund të refuzojë transferimin vetëm për arsytet e parashikuara në paragrafin 3. të nenit 63 të këtij ligji*”, ndërlidhur me këtë neni 63 paragrafi 3 i këtij ligji ka përcaktuar se: “*3. Transferimi i përkohshëm i nëpunëses/it civil, është vendim i drejtueses/it më të lartë të institucionit dhe mund të refuzohet nga shërbyesja/ i civil në këto raste: 3.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur; 3.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë së njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil*”.

Bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji erdhi në përfundimin së organi përkatësi i punësimit, në këtë rast Komisioni i Ristrukturimit i AKKVP-së, ka zbatuar dejtë ligjin material me rastin e propozimit të transferimit të ankuesit duke vepruar kështu në pajtim të plotë me nenin 66 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 12, 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për

Transferimin e Nëpunësve Civilë, ndërsa, Vendimi Nr. 56/2024 i datës 23.12.2024, i Udhëheqësit të Divizionit të Burimeve Njerëzore të AKKV-së është nxjerr në pajtim me nenin 66 paragrafi 4 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe nenin 14 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë dhe së akti i kundërshtuar përmban elementet të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse i njëjti akt përmban dispozitiv të qartë, arsytim konkret dhe udhëzime për mjet juridik, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.188/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Naim Cahanaj;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në AKKVP;
- Arkivit të KPMSHCK-së